



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-110
Prishtinë, më 6 korrik 2010, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 KORRIK 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Xhezair Murati dhe Branislav Grbiç.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Selman Ymeri dhe Shefki Shoshaj.

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati,
Nga ZCN: Blerta Bejtullahu dhe
Nga NDI, Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 qershor 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

Para fillimit të shqyrtimit të rendit të ditës, anëtari i Kryesisë Slobodan Petroviç, diskutoi lidhur me rastin e tentim vrasjes në Mitrovicë, të shefit të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetit Petar Miletiq. Ai falënderoi Kuvendin dhe të gjitha grupet parlamentare për përkrahjen që i dhanë deputetit Miletiq dhe dënimin e këtij akti. Kryetari i Kuvendit, shprehi keqardhje për këtë rast ndërsa deputetit Miletiq i uroj shërim të shpejtë.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 qershor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që në mbledhjen tjetër të radhës, me 8 korrik 2010 të shqyrtohen këto pika:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësorë të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorin e Shtetit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore,

8. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Kodit të drejtësisë për të mitur,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009,
11. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës, për vitin 2009,
12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik,
13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit,
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale “Lama e drunjtëve”, në Prishtinë.

Kryesia vendosi që edhe pika të tjera, që përgatiten ndërkohë, mund të radhiten në rend dite për mbledhjen plenare të ardhshme.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale në vendin e quajtur “Lama e drunjtëve”, në Prishtinë

Kryesia lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale në vendin e quajtur “Lama e drunjtëve”, në Prishtinë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, që ta shqyrtojë Propozim – Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale në vendin e quajtur “Lama e drunjtëve”, në Prishtinë, dhe Kuvendit t’i paraqes Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011

Kryesia lidhur me Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtoi kërkesën buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011, dhe nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, që në fazat e mëtejme të procedimit me kërkesën buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2011, të insiston që kërkesat fillestare të Kuvendit, të përfshihen në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

3.3 Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me rishikimin e Propozim-buxhetit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për, vitin 2010

Kryesia shqyrtoi njoftimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me rishikimin e Propozim-buxhetit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për, vitin 2010, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia konstatoi se, në ndërkohë Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës, e ka dërguar në Kuvend Raportin financiar për vitin 2009, si dhe Raportin financiar janar- mars 2010.
2. Kryesia vendosi që këto dy dokumente tu shpërndahen deputetëve dhe Komisionit për Buxhet e Financa, si komision funksional.

3.4 Njoftimi me Rekomandimin e Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike lidhur me Raportet vjetore te RTK-së

Kryesia pasi shqyrtoi njoftimin me Rekomandimin e Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike lidhur me Raportet vjetore te RTK-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga RTK-ja që Kuvendit të Republikës së Kosovës ti paraqes Raportin e auditimit të performancës, për vitin 2009, ashtu siç është kërkuar në Vendimin e mbledhjes plenare nr. 03-V-237, dt. 28 janar 2010.

3.5 Njoftimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit, për iniciimin e procedurës për kundërvajtje, ndaj deputetit Slavisha Petković

Kryesia pasi shqyrtoi njoftimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për iniciimin e procedurës për kundërvajtje, ndaj deputetit Slavisha Petković, vendosi që lidhur për këtë çështje të vazhdoj Agjencia sipas procedurave të veta që i ka në lidhje me raste të tilla.

3.6 Kërkesa e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për lejimin e udhëtimit zyrtar në Slloveni

Kryesia pasi shqyrtoi Kërkesën e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për lejimin e udhëtimit zyrtar në Slloveni për (8 deputet dhe 2 zyrtar), prej 11 deri 14 korrik 2010, në organizim të UNDP dhe NDI, nxori këtë

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në këtë përbërje: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Vezira Emrush, Flora Brovina, Teuta Hadri, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Syla dhe Qamile Morina si dhe Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit dhe Teuta Berisha-përkthyes, në Parlamentin e Sllovenisë, prej 11 deri më 14 korrik 2010.
2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon UNDP-ja dhe të NDI-ja, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03- V- 094.
3. Ngarkohet administrata e Kuvendit që ta zbatoj këtë vendim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:40.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale